

Në bazë të nenit 50 paragrafit 2 të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore -Shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/08, 103/08, 24/11, 80/12, 24/13, 147/13, 41/14, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/20 dhe 163/21) dhe neni 4 i Rregullores për mënyrën dhe procedurën e financimit të projekteve ose programeve kërkimore-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/09, 149/09, 34/11 dhe 129/13), dhe Konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratuar në seancën e 71-të të mbajtur më 29 prill 2025, dhe Aktvendimi për publikimin e Konkursit për financimin projekteve kërkimore – shkencore nga interes i veçant dhe publik për vitin 2025 (mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit akademit dhe të sektorit në kuadër të specializimit intelegjent) nr. 15-6443/1 të datës 30.04.2025, Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall

## KONKURS

**për financimin e projekteve kërkimore - shkencore me interes të veçantë shkencor dhe publik për vitin 2025**

**(mbështetja e bashkëpunimit ndërmjetë sektorit akademik dhe të biznesit në kuadër të specializimit intelegjent)**

### **Interes i veçantë shkencor dhe publik**

Për krijimin e ekonomisë konkurruese, e cila bazohet në inovacion dhe njohuri, është e domosdoshme të përfordhen lidhjet dhe partneritetet ndërmjet universiteteve shtetërore -fakulteteve/instituteve shkencore, bizneset, shoqatave dhe palëve të tjera të interesuara, për të shfrytëzuar së bashku kapacitetet dhe potencialet ekzistuese për zhvillim. Me financim në kuadër të këtij Konkursi inkurajohet krijimi dhe formalizimi i bashkëpunimit dhe partneritetit afatgjatë ndërmjet palëve të heliksit të katërt (universitete shtetërore-fakultete/institute shkencore, biznese, institucione shtetërore dhe sektori civil), në bazë të hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit.

## 1. Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij Konkursi është zhvillimi dhe implementimi i projekteve kërkimore - shkencore, në kuadër të cilave do të vendoset dhe formalizohet bashkëpunimi afatgjatë midis universiteteve-fakulteteve/instituteve shkencore shtetërore dhe ndërmarrjeve të sektorit privat, si dhe palëve të tjera të interesuara nga heliksi i katërtë. Bashkëpunimi i vendosur duhet të nxisë rritjen e gjelbër dhe të qëndrueshme duke përfshirë njohuritë, inovacionin dhe teknologjinë, për krijimin e produkteve dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar të cilat do të jenë konkurruese në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

## 1. Llojet e projekteve të cilat do të mbështeten dhe rezultatet e pritura

1.1 Me Konkursin financiarisht do të mbështeten projektet shkencore hulumtuese të cilat përfshijnë bashkëpunimin e universiteteve shtetërore-fakulteteve/instituteve shkencore të cilat do të krijojnë bashkëpunim me ndërmarrjet e sektorit privat, si dhe palë të tjera të interesuara të heliksit të katërt. Bashkëpunimi duhet të synojë aktivitetet kërkimore - shkencore dhe zhvillimin, si dhe miratimin ose përshtatjen e teknologjive inovative dhe të përparuara, proceseve teknologjike dhe know-how në ndonjërin nga fushat e Strategjisë së Specializimit Inteligent edhe atë:

1. Bujqësi dhe ushqim inteligjent me vlerë të shtuar më të lartë,
2. Teknologjitë Informatike dhe të Komunikimit (TIK),
3. Industria Elektro-makinerike-Industria 4.0,
4. Materiale të qëndrueshme dhe ndërtesa inteligjente,

duke përfshirë dy fushat prioritare horizontale, energjinë e së ardhmes dhe turizmin, të cilat kanë lidhje të ndërsjella me zonat vertikale dhe kanë potenciale për inovacion të kryqëzuar.

1.2. Projektet duhet të demonstrojnë karakter të qartë shumëdisiplinor dhe bashkëpunim efektiv midis palëve akademike, industriale dhe palëve të tjera të interesuara, me fokus në rezultatet praktike dhe me ndikimi.

1.3. Për institucionet kërkimore - shkencore si Bartës i Projektit, bashkëpunimi duhet të rezultojë me:

- Projekte kërkimore - shkencore të krijuara në bashkëpunim me industrinë, duke forcuar kapacitetet për bashkëpunim kërkimor - shkencor,
- Gatishmëri e shtuar për përgjigje të kërkesave dhe nevojave specifike të sektorit privat, transferimit të njohurive dhe aftësive;
- Zhvillimi i shërbimeve të cilat do t'i ofrohen sektorit privat dhe të cilat janë në fushat e specializimit inteligjent;
- Përfshirja e hulumtuesve të rinj në projekte.

1.4. Me subjektet afariste si partner të projektit, bashkëpunimi duhet të rezultojë me:

- Krijimi i kushteve për zhvillimin e inovacioneve, gjegjësisht produkteve dhe/ose shërbimeve të reja;
- Inicimi i bashkëpunimit me universitetet-fakultetet/institutet shkencore shtetërore, si dhe me palët e tjera të interesuara të helksit të katërt, ndërsa drejt aktiviteteve të përbashkëta të kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit;
- Zhvillimi i kapitalit dhe aftësive njerëzore;

- Gatishmëri më e mirë për ndërkombëtarizim dhe të kërkesave të miratuara të tregut global;

- Rritja e produktivitetit dhe efikasitetit të punës.

1.5. Priten projektet e financuara të kontribuojnë në rritjen e bashkëpunimit akademik-industrial dhe të kontribuojnë në avancimin e performancave inovative në fushën e veprimtarisë kërkimore - shkencore dhe në kuadër të sektorit privat. Projektet duhet të synojnë zhvillimin e inovacioneve të cilat zhvillohen në kushte reale, me fizibilitet të konfirmuar dhe në bazë të kërkesën reale të tregut.

1.6. Në kuadër të këtij Konkursi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të financojë projekte kërkimore - shkencore të cilat janë në nivel të gatishmërisë teknologjike nga niveli 3 deri në nivelin 6. Nivelet e gatishmërisë teknologjike (Technology readiness level-TRL) mund të shihen në linkun e mëposhtëm:

<https://horizoneuropencportal.eu/sites/default/files/2022-12/trl-assessment-tool-guide-final.pdf>.

1.7. Në kuadër të fletëparaqitjes, Bartësi i projektit do të duhet në mënyrë koncize të shpjegojë fazat e mëparshme të kerkimit shkencor dhe të tregojë gatishmëri për të vazhduar në fazën tjetër.

## **2. Kush mund të aplikojë?**

2.1. Të drejtë aplikimi në këtë Konkurs kanë Universitetet-fakultetet/institutet shkencore shtetërore të cilat do të krijojnë bashkëpunim me ndërmarrjet.

2.2. Bartës i projektit është universiteti shtetror - fakulteti/instituti shkencor.

2.3. Gjatë aplikimit, bartësi i projektit duhet të krijojë partneritet gjegjësisht bashkëpunim me ndërmarrjet/en të sektorit privat, ndërsa do të konsiderohet avantazh nëse në bashkëpunim do të përfshihen dhe institucione të tjera nga helsinku i katërt.

2.4. Me ndërmarrje të sektorit privat nënkuptohet subjekt afarist, gjegjësisht person juridik, i themeluar në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe i

regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Veprimtari kryesore e ndërmarrjes duhet të jetë në fushat e specializimit intelektual, për të cilin ndërmarrja paraqet dokument nga Regjistri Qendror për statusin aktual (jo më të vjetër se 6 muaj).

2.6. Partneritetet duhet të formalizohen me Marrëveshje, në të cilat do të përcaktohen qartë roli, detyrat, aktivitetet dhe përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të partneritetit, si dhe të drejtën për të disponuar rezultatet e projektit, ndërsa në përputhje me nenin 50 paragrafin 6 të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore - Shkencore. Marrëveshja e partneritetit është pjesë përbërse e aplikimit.

2.7. Marrëveshja e partneritetit duhet të vërtetohet në noter pasi projekti të miratohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2.8. Nëse, në kuadër të projektit kërkimor - shkencor, lind nevoja për të rregulluar të drejtat e pronësisë intelektuale gjegjësisht industriale, të njëjtat do të rregullohen në përputhje me regullativën ekzistues ligjore (Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji për Veprimtarinë Kërkimore - Shkencore, Ligji për Pronësinë Industriale) në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Bartësit të Projektit.

### **3. Ekipi i projektit**

3.1. Ekipi i projektit duhet t'i përfaqësojë partnerët në projektin dhe të ketë të paktën pesë anëtarë. Përveç asaj ekipi duhet të ketë:

- Një person përgjegjës për realizimin dhe koordinimin e projektit;
- Hulumtues kryesor me titull shkencor ose mësimor-shkencor i cili është i punësuar në fakultetin/institutin shkencor i cili është Bartës i Projektit;
- Të paktën edhe një hulumtues me titull shkencor gjegjësisht titull mësimor-shkencor;
- Të paktën dy hulumtues të rinj (studentë në vitin e fundit të studimeve deridiplomike, studentë të magjistraturës, studimeve të doktoraturës, bursistë shtetërorë të cilët kanë studiuar dhe studiojnë jashtë vendit, me të cilën do të mundësonte transferim më të shpejtë të njohurive nga vendet e zhvilluara);

- Në ekipin hulumtues mund të përfshihet edhe hulumtues i huaj pa të drejtë të mjeteve financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3.2. Do të konsiderohet si përparsi nëse në ekip është përfshirë person përfaqësues i ndërmarrjes partnere të projektit.

3.3. Çdo anëtar i ekipit të projektit duhet të nënshkruajë deklaratë për pëlqim për pjesëmarrjen e tij në projekt.

3.4 Anëtar i ekipit i cili është përfitues i financimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk mund të jetë anëtar i ekipit të projekti tjetër përfitues në kuadër të këtij Konkursi.

#### **4. Buxheti dhe metoda e financimit**

4.1. Në financimin e projektit në kuadër të këtij Konkursi është siguruar buxhet i përgjithshëm prej

32.000.000 denarë.

4.2. Për realizimin e projekti individual, Ministria e Arsimit dhe Shkencës siguron mbështetje financiare më së shumti deri në 8.000.000 denarë për kohëzgjatjen e projektit deri në 2 (dy) vjet, duke e konsideruar vitin 2025 si vitin fillestar gjegjësisht viti i parë për realizimin e projektit dhe 31 tetor 2026 si afat përfundimtar për realizimin e projektit.

4.3. Mjetet për vitin e parë fiskal ndahen pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërsa do të vazhdojnë edhe për vitin e dytë fiskal përderisa zgjat projekti, por jo më shumë se 2 (dy) vjet.

4.4. Në vitin e parë (2025) të realizimit të projektit, mund të miratohen mjete në vlerë prej më së shumti 50% të vlerës së projektit, por jo më shumë se 4.000.000 denarë.

4.5 Financimi i projektit do të zhvillohet sipas dinamikës dhe fazave të përcaktuara të projekti.

4.6 Mjetet do të ndahen në bazë të kërkesës me shkrim të dorëzuar nga bartës i Projektit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në përputhje me planin financiar i cili është pjesë përbërse e marrëveshjes. Për mjetet e ndara fakultetit/institutit shkencor detyrimisht, në çdo 4 (katër) muaj, përveç raportit financiar, dorëzon raport narrativ, si dhe dokumentacion të kostove faktike të kryera për realizimin

e projektit. Mjetet për 4 muajt e ardhshëm ndahen pas miratimit të raporteve për realizimin e aktiviteteve në periudhën katërmujore të mëparshme.

4.7 Nëse, pas përfundimit të projektit, përcaktohet se mjetet ose pjesë e mjeteve të ndara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës janë shpenzuar pa qëllime dhe në të kundërt të marrëveshjes dhe planit financiar pjesë përbërëse e marrëveshjes, fakulteti/instituti shkencor detyrimisht i kthen këto mjete, gjegjësisht i paguan në llogarinë e Ministrisë. Për të njëjtën, para lidhjes së marrëveshjes, dekani/drejtori i institutit - bartësi i projektit, do të dotrëzojë deklaratë se nën përgjegjësi të plotë morale dhe materiale, mjetet e ndara do t'i shfrytëzojnë ekskluzivisht për qëllimin e synuar.

4.8. Projektet e miratuara do të financohen në varësi të mjeteve të disponueshme nga Buxheti për vitin 2025, të parashikuara për këtë qëllim, derisa të shterohen mjetet.

4.9. Ministria e Arsimit dhe Shkencës mbanë të drejtën për të mos ndarë mjete përderisa nuk ka propozim-projekte të mjaftueshme ose nuk plotësohen kushtet për ndarjen e mjeteve.

4.10. Mjetet për financimin e projekteve nga Konkursi sigurohen nga Buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ndarja 16001, Programi 7, Nënprogrami 71-Puna Kërkimore - Shkencore, zëri 464 dhe Nënprogrami 75-Strategjia e Specializimit Inteligent, zëri 464.

## **5. Kohëzgjatja e projektit**

5.1. realizimi i projektit duhet të përfundojë deri më 31 tetor 2026.

5.2. Raporti përfundimtar për realizimin e projektit duhet të dorëzohet më së voni deri në 1 (një) muaj pas përfundimit të projektit.

5.3. Duke pasur parasysh se nuk ekziston mundësia për vazhdimin e kohëzgjatjes së projekteve, rekomandohen aktivitetet projektuese të prashikuara të përfundojnë jo më vonë se 2 muaj para datës së përfundimit të projektit.

## **Aktivitetet e projektit**

6.1. Aktivitetet që mund të përmbajë projekti janë: kërkimi dhe zhvillimi, zhvillimi i linjave/produkteve dhe ose shërbimeve pilot, testimi dhe validimi i produkteve/shërbimeve/proceseve të reja dhe/ose të përmirësuar, mbrojtja e pronësisë intelektuale, dizajni industrial, dizajni i produkteve dhe shërbimeve, kërkimi i tregut, zhvillimi i aftësive dhe trajnimi, përhapja e përvojës nga projekti tek palët e treta,

aktivitete për të inkurajuar dialogun e vazhdueshëm midis akademisë dhe biznesit dhe aktivitete të tjera që lidhen me objektivat e projektit.

6.2. Aplikantët pritët të parashikojnë përgatitjen e studimit përfundimtar dhe të prezantojnë rezultatet e projektit.

6.3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës rezervon të drejtën për të negociuar me projektet e përzgjedhura në lidhje me përcaktimin e aktiviteteve dhe buxhetin e projektit bazuar në rekomandimet e marra nga recenzentët, dhe para nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit të Projektit.

## **7.Kostot e pranueshme për financim**

7.1. Kostot e parashikuara në buxhetin e projektit duhet të korrespondojnë me aktivitetet e parashikuara në aplikim.

7.2. Vetëm kostot e kryera për aktivitetet e kryera gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe të cilat janë në përputhje me Buxhetin e miratuar të Projektit, do të konsiderohen kosto të pranueshme.

7.3. Kostot e pranueshme janë: kostot për materiale dhe lëndë të para, shpenzimet e udhëtimit, mëditjet, tarifat për angazhimin e ekspertëve, shërbimet prodhuese dhe jo-prodhuese, kostot për kërkimin e tregut, mirëmbajtjen e pajisjeve, prokurimin e literaturës dhe kosto të tjera që janë në funksion të zbatimit të projektit (prokurimi/marrja me qira e pajisjeve të IT-së dhe kërkimit shkencor), publikimin e rezultateve të projektit, kostot për botimin në revista, organizimin dhe pjesëmarrjen në takime dhe ngjarje shkencore, kostot që lidhen me prezantimin publik të rezultateve të projektit, si dhe kosto të tjera që janë në funksion të zbatimit të projektit.

7.4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk do të financojë prokurimin e pajisjeve të reja të IT-së dhe pajisjeve laboratorike nëse ato janë blerë dhe financuar tashmë me mjete publike. Linku për mbikëqyrjen e pajisjeve laboratorike në vend: <https://mon.gov.mk/content/?id=4750>

7.5. Nëse buxheti i projektit përfshin kostot e qirasë që lidhen me shërbimet kërkimore në laboratorët me pajisje TIK, duhet të përdoren shërbimet e laboratorëve ekzistues në vend.

7.6. Pjesa maksimale e honorareve të autorëve do të jetë më së shumti 10% e vlerës së përgjithshme, gjegjësisht kostove të përgjithshme të projektit (vlera e përgjithshme e

projektit sipas planit financiar për projektin dhe kostot e përgjithshme të bëra për zbatimin e plotë të projektit të financuar përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës);

## **Procedura dhe afatet për realizimin e Konkursit**

- 8.1. Konkursi shpallet dhe zgjat 45 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.
- 8.2. Fakultetet/institutet shkencore dorëzojnë aplikim elektronik në portalin e-uslugi.mon.gov.mk dhe ngarkojnë dokumentet e nevojshme në përputhje me Konkursin për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve shkencore dhe kërkimore që lidhen me specializimin intelektual.
- 8.3. Projektet vlerësohen nga recensues të pavarur të përzgjedhur nga ministri i Arsimit dhe Shkencës nëpërmjet shpalljes publike.
- 8.4. Recensimi i projekteve bëhet në bazë të kriterëve të vlerësimit nga pika 9 e Konkursit, brenda 15 ditëve pas përfundimit të periudhës së aplikimit në Konkurs.
- 8.5. Komisioni i formuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës përpilon listë renditjeje të projekteve të vlerësuara pozitivisht, e cila publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe përgatit propozim-vendim për ndarjen e mjeteve, në afat prej 7 ditëve nga data e marrjes së projekteve të vlerësuara nga recensentët.
- 8.6. Komisioni përgatit dhe dorëzon Njoftim për secilin aplikant sipas Konkursit, për vlerësimin e projektit i cili përmban shpjegim të detajuar të vlerësimit të projektit dhe njoftimin e financimit të projektit ose refuzimin e financimit të projektit, si dhe informacione të tjera relevante me rëndësi për parashtruesin e aplikantit në lidhje me projektin dhe financimin e projektit.
- 8.7. Gjatë përgatitjes së listës së renditjes dhe propozim vendimit për ndarjen e mjeteve, përparësi do t'u jepet atyre projekteve të propozuara nga hulumtues kryesor që ka publikuar të paktën 2 punime në revista me faktorë ndikimi në tre vitet e fundit, si dhe hulumtues kryesor që ka publikuar të paktën 2 punime në revista të regjistruara në baza të dhënash ndërkombëtare ose revista me bord reduktues ndërkombëtar, ndërsa mjetete e tjera do t'u shpërndahen atyre që kanë më pak se dy ose nuk kanë publikuar punime të tilla.
- 8.8. Vendimin për financimin e projekteve e sjell ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së renditjes së projekteve të vlerësuara pozitivisht, propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve dhe mjeteve të disponueshme në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- 8.9. Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe fakulteti/instituti shkencor nënshkruajnë marrëveshje për financimin e projekteve shkencore dhe kërkimore, e cila përcakton të gjitha detyrimet e projektit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e sjelljes së Vendimit për financimin e projekteve.
- 8.10 Gjatë zbatimit të projektit, marrëveshja për financimin e projektit kërkimor-shkencor mund të ndryshohet dhe plotësohet brenda kuadrit të burimeve financiare të miratuara për zbatimin e projektit të specifikuar në marrëveshje, në masën që kjo nuk do të ketë ndikim në rezultatet e projektit.
- 8.11. Gjatë gjithë zbatimit të projektit, marrëveshja për financimin e projektit kërkimor - shkencor mund të ndryshohet dhe lotësohet brenda kuadrit të burimeve të përgjithshme financiare të miratuara për zërat e miratuar në planin financiar për zbatimin e projektit të përcaktuar në marrëveshje më së shumti prej 20% nga përfituesi i projektit **pa kërkuar miratim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës**, për të cilën është e domosdoshme që të njoftohet Ministria në afat prej 15 ditëve pas ndryshimit të bërë. **Nuk lejohet që të shtohen zëra të rinj brenda planit të miratuar financiar.**
- 8.12. Gjatë gjithë zbatimit të projektit, marrëveshja për financimin e projektit kërkimor - shkencor mund të ndryshohet brenda kuadrit të burimeve të përgjithshme financiare të miratuara për zërat e miratuar në planin financiar për zbatimin e projektit të specifikuar në marrëveshje me më shumë se 20%, për të cilat fakulteti/instituti **shkencor dorëzon Kërkesë për ndryshimin dhe plotësimin e marrëveshjes**. Pas Kërkesës së dorëzuar ministri i Arsimit dhe Shkencës formon komision që e shqyrton kërkesën dhe deri te ministri dorëzon propozim-vendim. **Nuk lejohet që të shtohen zëra të rinj brenda planit të miratuar financiar.**

## 9. Kriteret e vlerësimit

- 9.1. Propozim- projektet shqyrtohen nga dy ose më shumë recensues të pavarur në fusha të ndara: shkenca matematiko - natyrore, shkenca teknike dhe teknologjike, shkenca të mjeksisë dhe shëndetësisë , shkenca bioteknike, shkenca shoqërore dhe humane.
- 9.2. Kriteret sipas të cilave vlerësohet propozim-projekti janë:
- ✓ kontribut në thellimin dhe zgjerimin e njohurive shkencore
    - ✓ originalitetin e objektivave dhe përmbajtjes së hulumtimit
    - ✓ objektiva dhe aktivitete të detajuara të projektit me tregues të qartë dhe të matshëm, plan financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për zbatimin e projektit dhe justifikimi dhe realiteti i kostove në planin financiar të propozuar të nevojshme për zbatimin e projektit, përputhshmëria e planit të aktiviteteve me planin financiar;

- ✓ kompetenca e hulumtuesit kryesor dhe kompetenca dhe origjinaliteti i ekipit kërkimor,
- ✓ kontribut në trajnimin e studiuesve të rinj,
- ✓ rëndësia e hulumtimit në lidhje me objektivat e përcaktuara, përputhshmëria e objektivave dhe lëndës së hulumtimit me qëllimin dhe kushtet e këtij Konkursi;
- ✓ konkurrueshmëria për bashkëpunim ndërkombëtar

fizibiliteti i propozim- projektit (gjasat për arritjen e rezultateve të pritura dhe mundësitë për zbatimin e rezultateve në afat kohor real)

9.3. Secili prej kriterëve të vlerësimit të shënuara, recenzent të pavarur i vlerësojnë me notë 1 (vlera më e ulët) deri në 5 (vlera më e lartë). Projekti vlerësohet pozitivisht nëse merr notë mesatare prej të paktën 3.5.

## **10. Vlerësimi i rezultateve të projektit**

10.1. Gjatë zbatimit të projektit, gjegjësisht çdo 4 muaj, Bartësi i Projektit dorëzon raport narrativ dhe financiar për zbatimin e projektit. Më së voni 1 muaj pas përfundimit të projektit dorëzohet raport përfundimtar.

10.2. Pas dorëzimit të Raportit Përfundimtar, Bartësi i Projektit i cili është vlerësuar pozitivisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, është i detyruar të organizojë prezantim publik të rezultateve të projektit.

10.3. Vlerësimi i zbatimit të projektit dhe i rezultateve të arritura kryhet nga të paktën dy recensues, njëri prej të cilëve është recensuesi që ka vlerësuar propozimin e projektit. Në rast të mungesës së recensentit që ka vlerësuar projektin, zgjidhet një recensent i ri.

10.4. Gjatë recensimit dhe vlerësimit të raporteve, dispozitat për vlerësimin e propozimit të projektit nga pika 9 e propozim-projektit të Konkursit do të zbatohen në përputhje me rrethanat.

10.5. Recensentët për vlerësimin e përcaktuar japin arsyetim të detajuar për të njejtën dhe japin vërejtje të hollësishme në rast të devijimeve, ndërsa e detyrueshme në rastin e vlerësimit të projektit me notë prej 3.5 dhe më pak.

10.6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës njofton aplikantin me shkrim për veprimet e ndërmarra mbi vërejtjet e bëra nga recensentët. Aplikanti duhet të veprojë mbi komentet e marra nga recensentët brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10.7. Nota maksimal për arritjen e rezultateve të projektit është 5.

## 11. Dorëzimi i Aplikimeve sipas Konkursit

11.1. Fletëparaqitja për projekte kërkimore-shkencore plotësohet në formë elektronike në portalin [e-uslugi.mon.gov.mk](http://e-uslugi.mon.gov.mk) dhe, në përputhje me Konkursin, bashkëngjiten dokumentet e nevojshme:

- Statusi aktual nga Regjistri Qendror për partnerin, sipërmarrjen në fushën e specializimit inteligjent (jo më i vjetër se 6 muaj),
- Marrëveshje bashkëpunimi ose partneriteti (midis bashkëpunëtorëve ose partnerëve të heliksit të katërt),
- Deklaratë pëlqimi të secilit anëtar të ekipit të projektit për të marrë pjesë në projekt,
- Deklaratë pëlqimi i Bartësit të Projektit (Dekanit/Drejtorit të Institutit) për pranimin e kushteve të Konkursit,
- Biografite e anëtarëve të ekipit, maksimumi 5.

11.2. Fletëparaqitjet me të dhëna dhe dokumentacion jo të kompletuar, fletëparaqitjet e plotësuara në formular të papërshtatshëm, fletëparaqitjet dhe dokumentet që nuk janë verifikuar me nenëshkrim dhe vulë (siç tregohet në aplikim dhe dokumente), si dhe ato që nuk janë dorëzuar brenda afatit të caktuar, nuk do të shqyrtohen.

11.3. Aplikantët do të njoftohen për rezultatet e konkursit më së voni 30 ditë pas përfundimit të afatit të aplikimit.

11.4. Rezultatet e Konkursit do të publikohen në ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës: [www.mon.gov.mk](http://www.mon.gov.mk).

-----  
(Vendi dhe data)

Deklaratë për pëlqimin e Bartësit të Projektit  
për pranimin e kushteve të Konkursit për financimin e projekteve kërkimore - shkencore me interes të  
veçantë shkencor dhe publik për vitin 2025 (mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit akademik  
dhe sektorit të biznesit në kuadër të specializimit intelektual)

- Unë, i nënshkruari më poshtë, nën përgjegjësi të plotë morale dhe materiale deklaroj se:
- në kuadër të projektit, hulumtimit dhe rezultatet e projektit do të prezantohen në takim shkencor - profesional, gjegjësisht ngjarje në përputhje me fushën kërkimore - shkencore;
- pjesëmarrja maksimale e autorëve honorar do të jetë më së shumti 10% e vlerës së përgjithshme, gjegjësisht kostove të përgjithshme të projektit (vlera e përgjithshme e projektit sipas planit financiar për projektin dhe kostot e përgjithshme të bëra për realizimin e plotë të projektit të financuar përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës);
- pas përfundimit të projektit, do të dorëzohet raport përfundimtar (pjesa financiare dhe narrative) për realizimin e projektit;
- projekti, me informatë për rezime, qëllime dhe rezultate, do të prezentohen në ueb-faqen e përfituesit prashtrues i fletëparaqitjes për Financim të Projektit dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në afat prej 30 ditëve pas datës së përfundimit të projektit;
- pas përfundimit të projektit, do të jepet deklaratë se mjetet e fituara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për financimin e projektit në fjalë janë burimi i vetëm i mjeteve për pagesën e kostove për qëllimin për të cilin janë transferuar këto mjete, si dhe se nuk ka detyrime financiare të pashlyera për projektin në fjalë;
- hulumtues kryesor nuk është person i cili, në projekt të mëparshëm të financuar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk i ka përmbushur kërkesat ligjore, gjegjësisht nuk ka dorëzuar raport vjetor ose përfundimtar për projektin e mëparshëm ose i njejtë është vlerësuar negativisht;
- Projekti nuk është identik në përmbajtje me asnjë projekt tjetër kërkimor - shkencor të kaluar ose aktual; Nëse projekti përfshin kërkime me pacientë ose materiale biologjike nga pacientët ose kërkime me kafshë eksperimentale, deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të dorëzohet miratim komiteti etik institucionit.

-----  
Dekani / Drejtori i Institutit  
Fakulteti / Instituti/